



**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**  
**MIDIS**  
**UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" TË GJIROKASTRËS (SHQIPËRI)**  
**DHE**  
**UNIVERSITETIT "KADRI ZEKA" TË GJILANIT (KOSOVË)**

Universiteti i Gjirokastrës (Shqipëri) i përfaqësuar ligjërisht nga Rektori Prof. Dr. Gëzim Sala dhe Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan i përfaqësuar ligjërisht nga Rektori Prof. Dr. Arben Dermaku bien dakord të nënshkruajnë një marrëveshje bashkëpunimi në fushën akademiko – shkencore.

Të dyja institucionet do të bëjnë çdo përpjekje për të forcuar kontaktet direkte dhe bashkëpunimin kërkimor midis antarëve të departamenteve dhe fakulteteve të tyre respektive.

Midis tyre është rënë dakord dhe nënshkruhet si më poshtë:

**Neni 1**

Universitetet që nënshkruajnë këtë marrëveshje impenjohen së bashku për të forcuar dhe zgjeruar marrëdhëniet e tyre, që kanë të bëjnë me shkëmbimet reciproke dhe bashkëpunimin në projektet kërkimore në fushat e tyre respektive. Për këtë arsye të dy universitetet impenjohen në kryerjen e çdo lloj aktiviteti që nevojitet për përmirësimin e marrëveshjes në fjalë dhe të objektivave të saj, si dhe zgjerimin e tyre.

## Neni 2

Për realizimin e objektivave të cituara në Neni 1, universitetet do të impenjohen bashkarisht për:

1. shkëmbimin e vizitave të antarëve të stafit didaktik dhe kërkimor, të cilat kanë për qëllim promovimin e seminareve, kurseve, konferencave, përgatitjen e projekteve kërkimore në kuadër të programeve të ndryshme dhe shkëmbimin e eksperiencave në fushat me interes të përbashkët.
2. qarkullim të botimeve, materialeve akademike dhe informacionit për fusha të caktuara studimore dhe kërkimore të përfshira në marrëveshje dhe që kanë interes të përbashkët.
3. shkëmbim reciprok i pedagogëve, kërkuesve dhe teknikëve për zhvillimin e aktiviteteve didaktiko – shkencore të integruara.
4. shkëmbim studentësh pasuniversitarë dhe personelit kërkimor ndërmjet dy universiteteve me qëllim ndjekjen e seminareve, ekzekutim të ushtrimeve laboratorike dhe përgjithësisht në realizimin e kërkimeve me perspektivën e kryerjes së disertacioneve sipas planifikimit të dy universiteteve.
5. të vihen në funksion bashkarisht kurse studimi, diplomimi, kurse për mësimdhënie, master, doktoratura të nivelit të parë ose të dytë me mundësinë e lëshimit të titujve të përbashkët.
6. vizita të antarëve të personelit didaktik – shkencor me synim zhvillimin e kërkimeve në sektorët e ndryshëm të veprimtarisë së të dy institucioneve në forcimin e lidhjeve mes departamenteve.

## Neni 3

Bashkëpunimet e veçanta në kuadrin e kësaj marrëveshje do të përcaktohen në Protokolle të veçanta nga njësitë universitare analoge (fakultete, departamete) dhe do të firmosen nga përfaqësuesit kompetentë të çdo pale.

## Neni 4

Implementimi i aktiviteteve të parashikuara nga kjo marrëveshje do të bëhet e njohur fillimisht nga koordinatorët e përcaktuar nga çdo universitet. Ata do të punojnë bashkarisht për përgatitjen e aktiviteteve për të realizuar objektivat e programit përkatës.

## Neni 5

Universitetet që nënshkruajnë këtë marrëveshje kanë për qëllim të inkurajojnë shkëmbimet studentore dhe ato të stafit akademik në bazë të avantazheve reciproke. Kështu institucioni mikpritës do të mundësojë për palën tjetër çdo formë asistence, lehtësi informacioni apo didaktike për realizimin e detyrave të përcaktuara.

Përpara nisjes duke përjashtuar çfarëdo lloj përgjegjësie prej universitetit pritës, partnerët do të firmosin për çdo pedagog, kërkues, teknik ose student në lëvizje një policë sigurimi që garanton asistencën shëndetësore dhe çfarëdo forme tjetër asistence që është e nevojshme.

Nëse nuk ka një marrëveshje tjetër midis palëve e cila i bashkangjitet programit, shpenzimet e udhëtimit do të jenë në ngarkim të universitetit dërgues ndërsa fjetja dhe ushqimi do të jenë në ngarkim të universitetit pritës. Shpenzimet për çdo projekt të pranuar do të diskutohen dhe do të aprovohen sipas fondeve të disponueshme.

## Neni 6

Universitetet impenjohen të mbështesin çdo student të universitetit partner për pjesëmarrje në leksionet e lëndëve dhe kurseve studimore që ai ka.

Studentët me autorizim të universitetit nga vijnë mund të zgjedhin një numër kursesh midis atyre që ofron universiteti pritës. Çdo universitet do t'i lëshojë studentëve frekuentues një certifikatë që vërteton frekuentimin, studimet e kryera si dhe kreditet që kanë marrë. Universitetet do të vendosin me marrëveshje të përbashët sistemin e provimeve dhe vlerësimeve që duhet të adoptojnë me studentët e ardhur. Për ekuivalentimin e provimeve ose studimeve të kryera prej studentëve të njërit universitet tek universiteti tjetër, merret për bazë legjislacioni në fuqi i çdo vendi ku universitetet kanë marrëveshje.

Universitetet që kanë marrëveshje impenjohen për të vendosur një kriter reciprociteti për çfarë ka të bëjë me detyrat që lidhen me regjistrimet, taksat akademike dhe sigurimin universitar. Universitetet lënë të hapur mundësinë për të promovuar dhënien e bursave të studimit për studentët e palës tjetër.

## Neni 7

Zgjidhja e problemeve të ndryshme që lidhen me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje i lihet një kolegji arbitrazhi i përbërë prej një anëtari që caktohet prej secilit universitet, si dhe një personi tjetër i zgjedhur me marrëveshje të përbashkët.

## Neni 8

Kjo marrëveshje hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit të saj nga Rektori i universitetit të Gjirokastrës Prof. Dr. Gëzim Sala dhe Rektori i universitetit të Gjilanit "Kadri Zeka" Prof. Dr. Arben Dermaku, dhe zgjat për 3 vjet. Ajo mund të rinovohet automatikisht me përjashtim të rasteve kur njëra nga palët informon për pavlefshmërinë e saj, jo më vonë se gjashtë muaj para dates së skadimit. Kjo marrëveshje është shtypur në dy kopje në gjuhën shqipe. Të dyja kopjet kanë fuqi ligjore të njëjtë.

Gjirokastrë, 21.03.2014

**PËR UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ"  
TË GJIROKASTRËS**

**REKTORI**

**Prof. Dr. Gëzim Sala**

**PËR UNIVERSITETIN "KADRI ZEKA"  
TË GJILANIT**

**REKTORI**

**Prof. Dr. Arben Dermaku**